

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.G., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr. 1002/2015, dt. 01.04.2016, pas shqyrtimit fillestartë mbajtur me datë 05.09.2018, në të cilën ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit – Ilaz Beqiri dhe i pandehuri B.G., gjykata në tënjëjtën ditëtori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: B.G., i biri i N., dhe M., e gjinisë K., i lindur me dt. ..., në P., me vendbanim në rr “H.S.” nr ..., KK P., i pa martuar, student, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: Nga data e pa përcaktuar e deri me dt. 12.11.2015 rreth orës 02:45, i pandehuri pa autorizim ka poseduar armë, ashtu që gjatë një kontrolli turinor nga ana e pjesëtareve të KP-së, në rr “F.A.” në P., është ndaluar dhe kontrolluar i pandehuri, tek i cili është gjetur dhe sekuestruar revole e tipit “Bereta” me një karikator dhe tre fishek të kalibrit 4.65 të cilën e mbante pa autorizim.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,46,69,73,74,75, të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, e gjykon:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit **B.G.**, i caktohet dënim me gjobë **prej 500(pesëqind) euro**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj me 3 (tri) këste. Këstin e parë prej 200 (dyqind) euro, është i obliguar ta paguaj pas 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këstin e dytë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro obligohet ta paguaj 30 ditë pas pagesës së këstit të parë, ndërsa këstin e tretë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro obligohet ta paguaj 30 ditë pas pagesës së këstit të dytë.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë ashtu që në ditë burgimi do të llogaritet me 20 euro gjobë të shqiptuar.

Obligohet i pandehuri që të paguajshpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komform nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet: Arma (pistoleta) e tipit "Bereta", me nr. serik 7.65, dhe 3 (tre) fishekë me nr. serik 7 mm, dhe një karikator.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I.nr. 1002/2015, të datë 01.04.2016, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin B.G., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Me datë 05.09.2018, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I.nr. 1002/2015, të datë 01.04.2016, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykes pas i bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri B.G., ka deklaruar se ndihet plotësisht i fajshëm, ndihet keq për veprën e kryer duke theksuar se nuk i përket asaj natyre, natën kritike kishin një gazmend familjar në P., ku pas përfundimit me të arritur në P. është ndaluar nga ana e pjesëtarëve të policisë, sa i përket armës i pandehuri ka shtuar se arma gabimisht i ka mbetur në veturë për atë edhe e ka pranuar, pendohet për veprën e kryer, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më vepra penale.

Prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që të njëjtin pranim i pandehuri e ka bërë qysh nga fazat fillestare, pranimi i fajësisë është në përputhshmëri të plotë me gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që një pranim të tillë ta aprovojë, ngase i pandehuri ka kuptuar mirë pasojat dhe beneficionet e pranimit të fajësisë. Krejt në fund prokurori i shtetit ka shtuar se me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal gjykata të merr parasysh rrethanat lehtësuese se i pandehuri ka pranuar fajësinë, i njëjti është student, dhe ka premtuar se më nuk do të përsërisë vepër penale.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, siç janë: Vërtetimi mbi marrjen e sendeve i dt. 12.11.2015, foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethanave çanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, i njëjti është student, dhe premtimin e tij para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 69 të KPRK-së dhe 115 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikursenë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 202/16, datë05.09.2018**

**Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi**

**Gjyqtari:
Arben Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.